



A.nr. 192/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.192/2026, të parashtruar nga ankuesi A.SH, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Organit Shqyrtues të Prokurimit, në çështjen juridike-administrative “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 24.07.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa më numër A.nr.192/2026, e datës 23.02.2026, e parashtruar nga ankuesi A.SH, lidhur me pretendimet për anulimin e Vendimit me numër protokolli 108/2026, të datës 23.01.2026, të u.d. Kryetarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

**II. Hedhet poshtë si e palejuar** ankesa më numër A.nr.192/2026, e datës 23.02.2026, e parashtruar nga ankuesi A.SH, lidhur me pretendimi ankimor për anulimin e Vendimit me numër protokolli 107/2026, të datës 23.01.2026, të u.d. Kryetarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

## A r s y e t i m

Ankuesi A.SH, (*tutje referuar ankuesi*), më datë 23.02.2026 ( e plotësuar më datë 12.03.2026), ka parashtruar ankesë në KPMSHCK, kundër Vendimit me numër protokolli 107/2026, të datës 23.01.2026 dhe Vendimit me numër protokolli 108/2026, të datës 23.01.2026, të u.d. Kryetarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtë materiale, shkeljes së dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit ( me tej vetëm OSHP), ndërsa, ky i fundit, ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 934/2026 të datës 23.02.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emailin e datës 10.07.2023 nga A.B për B.B; Emailin e datës 11.09.2023 nga A.B për A.B; Emailin e datës 07.09.2025 nga A.B për A.B; Emailin e datës 22.01.2026 nga A.B për

ankuesin; Emailin e datës 30.12.2025 nga ankuesi për A.B; Vendimin me numër protokoli 107/26 të datës 23.01.2026 të u.d. Kryetarit të OSHP-së; Vendimin me numër protokoli 108/26 të datës 23.01.2026 të u.d. Kryetarit të OSHP-së; Emailin e datës 14.08.2023 nga A.B për ankuesin; Emailin e datës 11.08.2023 nga ankuesi për A.B; Raportin me numër protokoli 19/26 të datës 12.01.2026 të Komisionit përkatës për vlerësim të zbatimit të vendimeve gjyqësore; Opinion ligjor me Nr. 809 të datës 19.05.2023 të Drejtorit të DMZP-së; Njoftimin për OSHP i datës 16.01.2013 nga Drejtori i DASHC-së; Vendimin me numër protokoli 1267/25 të datës 09.09.2025 për caktimin e ankuesit ushtrues detyre i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së; Aktgjykimin A.nr.1662/2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesën për kthim në vendin e punës Kryesues i Sekretariatit të OSHP e datës 09.12.2025 nga A.B; Aktgjykimin AA.nr.968/2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Akt Emërimit të datës 05.02.2013 për pozitën Kryesues i Sekretarit të OSHP-së; Përshkrimin e detyrave të punë për pozitën Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së; Emailin e datës 04.10.2023 nga A.T për A.B; Emailin e datës 04.10.2023 dhe 02.10.2023 nga A.B për N.B dhe A.T; Emailin e datës 02.10.2023 nga N.B për A.B; Emailin e datës 04.10.2023 nga A.B për Q.B; Emailin e datës 10.10.2023 nga XH.Z për A.B; Emailin e datës 06.10.2023 nga A.B për XH.Z, N.K dhe A.T; Kopjen e ID-së së ankuesit; Plotësimin dhe ndryshimin e ankesës datë 12.03.2026; Emailin e datës 23.02.2026 nga OSHP për ankuesit dhe të tjerët; Vendimin A.n.928/2023 të KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 04.03.2026; Akt Emërimit të datës 23.10.2023 dhe 03.02.2026 të ankuesit; Vendimin me Nr. 99/224 të datës 02.02.2024 për caktimin zëvendësuesit të Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së.

### *I. Gjendja e fakteve*

Nga administrimi i provave materiale rezulton:

- Sipas Aktit të Emërimit me numër 97/2013, të datës 05.02.2013, z. A.B, ka mbajtur pozitën e punës Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së.
- Kryetarja e OSHP-së më Vendimin me numër 724/2023, të datës 23.06.2023, ka shfuqizuar Aktin e Emërimit të ankuesit me numër 97/2013, të datës 05.02.2013, me arsyetimin se kjo pozitë konsiderohet pozitë e nivelit të lartë drejtues dhe nuk mund të mbahet me akt emërim paafat.
- Zyrtari publik A.B kundër këtij vendimi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më datë 01.09.2023, ka nxjerr Vendimin A.nr.928/2023, më të cili ka refuzuar ankesën e palës duke e lënë në fuqi vendimin e kontestuar.
- Pala A.B kundër Vendimit A.nr.928/2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka iniciuar konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.
- Më Vendimin me numër protokoli 99/24 të datës 02.02.2024, Kryetarja e OSHP-së ka caktuar ankuesin si Zëvendës Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së.
- Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më Aktgjykimin A.nr.1662/2023 të datës 19.10.2024, ka aprovuar në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar Vendimin A.nr.928/2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.
- Më Vendimin me numër protokoli 1267/25, të datës 09.09.2025, u.d. Kryetari i OSHP-së ka caktuar ankuesin si ushtrues detyre i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së, më afat kohor prej një viti.
- Këshilli, kundër Aktgjykimit A.nr.1662/2023, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës. ndërsa, kjo e fundit më Aktgjykimin AA.nr.968/2024, të datës 04.11.2025, ka refuzuar ankesën e

Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

- Me qëllim të zbatimit të aktgjykimeve si më sipër, u.d. Kryetari i OSHP-së më datë 23.01.2026, ka nxjerr Vendim me numër protokolli 108/26, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 1267/25 të datës 09.09.2025 për caktimin e ankuesit si ushtrues detyre i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së, duke e kthyer të njëjtin në pozitën e mëparshme sipas akt emërimit në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Menaxhim Financiar, ndërsa, po më datë 23.01.2026, ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 107/26, me të cilin A.B nga data 01.02.2026, kthehet në pozitën e nivelit të lartë drejtues dy (2) Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së me mandat katër (4) vjeçar sipas nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

## *II. Pretendimet ankimore*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se vendimet e kontestuar janë të paligjshme sepse nuk i përmbajnë elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të LPPA-së, rrjedhimisht nuk ka arsyetim të plotë sipas nenit 48 të LPPA-së. Shton se ka moszbatim të plotë të vendimeve gjyqësore, sepse këto aktgjykime nuk kanë vendosur dhe nuk kanë dhënë autorizim për përcaktimin e mandatit, koeficientit ose klasifikimit si pozitë e nivelit të lartë drejtues 2 sikurse përcaktohet në Vendimin me numër protokolli 107/26. Me tej, ankuesi thekson se më Vendimin me numër protokolli 107/26, i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës pasi që i është cenuar statusi juridik në ushtrimin e pozitës si ushtrues detyre i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së, dhe ky vendim përbën shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, rrjedhimisht edhe Vendimi me numër protokolli 108/26, është i paligjshëm. Kërkon të aprovohet ankesa, të anulohet Vendimi me numër protokolli 107/2026, i datës 23.01.2026 dhe Vendimi me numër protokolli 108/2026, i datës 23.01.2026 të u.d. Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit, të urdhërohet rivendosja e gjendjes juridike me ligjin dhe të mundësohet vazhdimi i procedurës së konkursit të pezulluar për pozitën Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së.

## *III. Vlerësimi i Kolegjit të Këshillit*

Në kuptim të pretendimit ankimor se vendimet gjyqësore nuk kanë dhënë autorizim për përcaktimin e mandatit, koeficientit ose klasifikimit si pozitë e nivelit të lartë drejtues 2, Kolegji thekson faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më Aktgjykimin A.nr.1662/2023 të datës 18.10.2024 ( i plotfuqishëm sipas aktgjykimit AA.nr.968/2024 të datës 04.11.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative), pozita Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, nuk vlerësohet si pozitë e kategorisë së lartë drejtuese apo pozitë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, pasi që sipas gjykatës këtë rol e ka Kryetari i Bordit të OSHP-së.

Ndërsa, në ndërlidhje më pretendimin ankimor të ankuesit se me shfuqizimin e Vendimit me numër protokolli 1267/25 të datës 09.09.2025, ankuesit i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës pasi që i është cenuar statusi juridik në ushtrimin e pozitës si ushtrues detyre i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit mbi këtë bazë nuk kanë mbështetje ligjore, vendimi i kontestuar është nxjerr si pasojë e vendimit 107/2025, të datës 23.01.2025, ashtu që zyrtari A.B është kthyer në pozitën e Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së dhe domosdoshmërisht, Vendimin me numër protokolli 1267/25 i datës 09.09.2025 duhet të shfuqizoj pasi që

një pozitë nuk mund të ketë dy mbajtës dhe siç u tha më lartë ankuesi ka qenë vetëm i caktuar përkohësisht në pozitën e Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së.

Kolegji i Këshilli lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit përkitazi me kundërshtimin e Vendimit me numër protokolli 107/2026, të datës 23.01.2026, të u.d. Kryetarit të OSHP-së, iu referua nenit 27 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik më të cilin përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: “1. *Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike*, ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1, ku përcaktohet: “1. *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*”, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton së më Vendimin me numër protokolli 107/2026, të datës 23.01.2026, të u.d. Kryetarit të Organit Shqyrtues të Prokurimi, ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, sepse, akti i kontestuar ishte nxjerr në zbatim të Aktgjykimit të plotfuqishëm A.nr.1662/2023 të datës 19.10.2024, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe së ankuesi ka qenë i emëruar vetëm si ushtrues i përkohshëm i detyrës së Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së, kështu që, në vlerësimin e Kolegjit pala ankuese nuk ka legjitimitetin e palës aktive në procedurë, andaj, edhe ankesa lidhur me këtë pretendim ankimore konsiderohet e pranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, , ku përcaktohet se: “*Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji*”.

Bazuar për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi më nënshkrimin e tij nga kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda: A.nr.192/2026*

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit A.SH;
- OSHP: u.d Kryetarit dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.